

BASHKIA DIBËR

**RAPORTI MBI DËGJESAT PUBLIKE
HARTIMI I BUXHETIT 2026**

Dhjetor 2025

Hyrje

Raporti i detajuar i dëgjesave Publike, Bashkia Dibër.

Ky raport përfundimtar paraqet përmbledhjen e dëgjesave publike të zhvilluara nga **Bashkia Dibër** dhe **Këshilli Bashkiak Dibër** në të gjitha njësitë administrative dhe jo vetëm gjatë muajve **Tetor–Nëntor 2025**. Procesi i konsultimit publik është organizuar në kuadër të përgatitjes dhe hartimit të **Buxhetit për vitin 2026**, si dhe për të siguruar transparencë të plotë ndaj qytetarëve lidhur me projektet, investimet dhe shërbimet e realizuara gjatë vitit 2025.

Dëgjesat publike përbëjnë një instrument thelbësor për rritjen e pjesëmarrjes së komunitetit në vendimmarrje, duke krijuar hapësira reale për informim, dialog dhe shkëmbim mendimesh mbi prioritetet zhvillimore të bashkisë. Në përputhje me kërkesat e **Ligjit nr. 146/2014 “Për konsultimin publik”**, Bashkia Dibër ka garantuar kushte të përshtatshme për përfshirjen e të gjitha palëve të interesuara, duke u angazhuar të mbledhë, vlerësojë dhe marrë në konsideratë çdo propozim apo shqetësim të paraqitur nga qytetarët.

Ky raport përmbledh të gjitha temat e diskutimit, problematikat e evidentuara, sugjerimet dhe rekomandimet e komunitetit, si dhe përgjigjet dhe angazhimet e institucioneve vendore. Dokumenti synon të pasqyrojë në mënyrë transparente procesin e realizuar dhe të shërbejë si bazë për përmirësimin e planifikimit buxhetor dhe ofrimin e shërbimeve publike në territorin e Bashkisë Dibër.

Bashkia Dibër dhe Këshilli Bashkiak kanë bashkëpunuar ngushtësisht për përpilimin e kalendarëve, organizimin e takimeve dhe administrimin e dëgjesave në mënyrë sa më profesionale për të siguruar që asnjë kërkesë e qytetarëve të mos mbahet shënim dhe më pas të ndiqet deri në përmirësimin me sukses të zgjidhjes së problematikave. Problematikat më të shumta të cilët janë hasur në njësitë administrative vijnë kryesisht në problematikave.

Tabela me informacion për cdo takim të mbajtur.

NR	Njësitë Administrativ e	Data e takimit	Ora e takimit	Nr i pjesmarrësve	Nr i rekomanduesve
1	Kastriot	28.10.2025	10:00	40	10
2	Muhurr	28.10.2025	14:00	53	12
3	Luzni	04.11.2025	11:00	60	14
4	Melan	04.11.2025	13:00	43	10
5	Tomin	5.11.2025	13:00	55	11
6	Zall Rec	13.11.2025	11:00	15	3
7	ZallDardhe	13.11.2025	13:0	79	13
9	Arras	14.11.2025	11:00	53	12
10	Fushe Cidhen	14.11.2025	13:00	35	4
11	Maqellare	19.11.2025	14:00	95-100	16
12	Sllove	21.11.2025	11:00	34	8
13	Selishte	21.11.2025	11:00	30	11
14	Takim me grate	18.11.2025	11	54	17
15	Takim me të rinjtë	8.12.2025	13:00	35	12

Dëgjesa Publike – Njësia Administrative Kastriot


Data: **28 Tetor 2025**

Ora: **10:00**

Vendi: **Njësia Administrative Kastriot.**

Takimi u hap me përshëndetjen e Kryetarit të Bashkisë Dibër, **Rahim Spahiui** cili falënderoi pjesëmarrësit dhe prezantoi një përmbledhje të investimeve të kryera gjatë vitit 2025 në Njësinë Administrative Kastriot. Bashkë me kryetarin ishin prezentë kryetari i Këshillit Bashkiak **Sokol Sava**, anëtari **Hysen Uka**, të cilët folën për rëndësinë që dëgjesat publike kanë në hartimin e projektbuxhetit për vitin 2026. Të pranishëm në dëgjesë publike ishin afërsisht 45-50 persona dhe shqetësime ngritën 10 persona.

Më pas, komuniteti paraqiti problematikat dhe propozimet e tyre për investimet e ardhshme. Gjatë takimit u prezantuan investimet e realizuara në vitin 2025 në territorin e Njësisë Administrative Kastriot. Pjesëmarrësit evidentuan situatën aktuale të shërbimeve publike dhe sollën propozime për përmirësimin e infrastrukturës dhe menaxhimit të burimeve në nivel fshati. Diskutimet u fokusuan kryesisht në furnizimin me ujë të pijshëm, gjendjen e rrugëve, kanalizimet dhe menaxhimin e mbetjeve.



(Foto gjate takimit ne njësinë Kastriot)

Nevojat sipas fshatrave në Njësinë Administrative KASTRIOT

Sohodoll i Madh – XhevatCibaku

1. Nevojat: Mungesë e ujit të pijshëm, sidomos në lagjen Skender dhe Makishte. Nevojë për ndërhyrje në infrastrukturën rrugore. Kanalet ujitëse janë bllokuar dhe kanë nevojë që të mirëmbahen dhe një nevojë tjetër emergjente për Sohodollin e madh është pastrimi i Liqenit të Sohodollit.

Kryetari u shpreh se janë kryer disa investime në zonë, por mungesa e bashkëpunimit të komunitetit ka vështirësuar punën. U garantua se do të rishikohen ndërhyrjet në kanalizime dhe ujësjellës.

Limjan – Dukagjin Ricku (Kryeplak i fshatit Limjan)

Shpreh mirënjohjen e madhe për investimet e bëra në këtë fshat. Rruga e asfaltuar ishte një nevojë emergjente që i dha fshatit një ndihmë të madhe.

- Nevojat: Liqeni i fshatit nuk mban ujë; duhen rreth 300 m tubacione. Kanalizimet e ujërave të zeza janë të papërfunduara. Kërkohet shërbim i rregullt i mbledhjes së mbeturinave (1 herë në javë të vijë makina dhe ti marrë mbeturinat). Ndricimi rrugor është i nevojshëm për fshatin

-**Kryetari** falënderoi komunitetin për bashkëpunimin dhe konfirmoi se rruga e fshatit do të mirëmbajet rregullisht. Çështja e liqenit dhe kanalizimeve do të përfshihet në planin e punimeve.

Kuke – Ramadan Canaku

- Nevojat e fshatit Kuke: Problemi kryesor janë mbeturinat. Të bëhet një zgjidhje pasi për komunitetin është problematike. Ujërat e zeza derdhen në përrua. Nëse është mundësia të rregullohet 550 m rrugë dhe kemi nevojë për Nevojë për 6 tuba për kanalizimet. Falenderues për punën që është bërë deri tani. Bravo ju qoftë.

- **Kryetari** theksoi se menaxhimi i mbetjeve është prioritet dhe me përmirësimin e rrugës, makina e pastrimit do të hyjë në fshat më shpesh. Kanalizimet do të vlerësohen për ndërhyrje.

Brest i Sipërm – Nebi C.

-Nevojat: Kanalet e ujërave të zeza kanë dalë në asfalt. Probleme me ujin e pijshëm dhe abuzime me përdorimin e tij. Kërkohet vendosja e pengesave për uljen e shpejtësisë së mjeteve.

-**Kryetari** shpjegoi se pengesat rrugore nuk mund të vendosen sepse rruga administrohet nga ARSH. Megjithatë, problemi i kanalizimeve do të trajtohet nga strukturat teknike.

Kastriot – Hajredin Xhini

-Nevojat– Problem i vazhdueshëm me ujin e pijshëm dhe abuzim në konsum. Kërkohet sistemim i zonës së lapidarit si vend me vlerë historike.

-**Kryetari** pohoi se vendosja e matësave të ujit është zgjidhje e nevojshme dhe do të planifikohet. Po ashtu, lapidari do të futet në planin e ndërhyrjeve estetike.

Vakuf – Rifan Hoxha

-Nevojat: Rruga e fshatit është dëmtuar. Uji i pijshëm është përmirësuar, por uji vaditës keqmenaxhohet.

-**Kryetari** propozoi që menaxhimi i ujit vaditës t'i jepet një personi të caktuar për të shmangur abuzimet. Për sa i përket rrugësh është në plan mirëmbajtje për cdo fshat.

Përgjegje – Shemi Përgjegji

-Nevojat e lagjes Përgjegje– Zona është e ndotur dhe mbeturinat janë problem i vazhdueshëm.

-Kryetari premtoi ndjekje të menjëhershme të situatës dhe vendosje të pikave të reja të grumbullimit të mbetjeve.

Kishavec – Arif

-Nevojat- Rruga e fshatit është në gjendje të rënduar.Duhet ndërhyrje me prita pasi zona rrezikon përmbetje.

-Kryetari:Emergjencat Civile do të përgatisin një projekt për pritë mbrojtëse, duke e konsideruar zonën me prioritet. Për sa i përket rrugës e ke pa besoj qe po e Asfaltojme.

Kanëder (Lagjja Hase) – Lavdrim Hasi

Nevojat: Uji i pijshëm nuk vjen fare në lagje.

– Uji i pijshëm nuk vjen fare në lagje.700 metra rrugë janë të dëmtuara dhe me baltë, duke vështirësuar lëvizjen e fëmijëve.

-Kryetari tha se furnizimi me ujë në këtë lagje do të analizohet urgjentisht dhe segmenti rrugor do të përfshihet në planin e rehabilitimit.

Përmbledhje e kërkesave nga degjësat publike Njësia Kastriot, te vitit 2025

Përmbledhje e kërkesave nga degjësas publike te vitit 2025																			
Nr	Njesia Administ rative	Data zhvillimit te degjeses publike	Diskutanti (Emer e Mbiemer)	Fshati (qe perfshin diskutimin)	Cfare kerkohet	Asfaltim rruge	Rregullim rruge me kalldrem	Uje i Pishem	Uje vadites	Ndricim RRUGOR	Sisteminim i Ujrave te zeza	Pastrim Kanalesh vaditese	Sisteminim mbeturinash	Problem me energjine	Shkolla, njesi shendetesore	Punetor mirembatje	Pastrim i Liqenit	Prita per permbytjet	
1	Kastriot	10.10.2025	Xhevat Cibaku	Sohodoll i Madh		1		1	1										4
2	Kastriot	10.10.2025	Dukagjin Ricku	Limjan					1	1		1					1		4
3	Kastriot	10.10.2025	Ramadan Canaku	Kukaj							1		1				1		2
4	Kastriot	10.10.2025	Nebi C	Brest i Poshtem				1			1								2
5	Kastriot	10.10.2025	Hajredin Xhini	Kastriot				1											1
6	Kastriot	10.10.2025	Rifan Hoxha	Vakuf		1			1										2
7	Kastriot	10.10.2025	Shemsi Pergjegji	Pergjegje									1						1
8	Kastriot	10.10.2025	Arif	Kishavec		1													2
9	Kastriot	10.10.2025	Lavdrim Hasi	Kanderr			1	1										1	2
10	Kastriot	10.10.2026																	2
totali kërkesave						3	1	4	3	1	2	1	2				2	1	20

Dëgjesa Publike – Njësia Administrative Muhurr

Data: 28 Tetor 2025

Ora: 14:00

Vendi: Lokal i fshatit Rreth Kale, Njësia Administrative Muhurr

Takimi u hap me përshëndetjen e Kryetarit të Bashkisë Dibër, Rahim Spahiu i cili falënderoi pjesëmarrësit dhe prezantoi një përmbledhje të investimeve të kryera gjatë vitit 2025 në Njësine Administrative Muhurr. Të pranishëm në këtë dëgjese ishin deputetja e partisë socialiste Alma Selami, Kryetari këshillit bashkiak Sokol Sava, staf teknik i bashkisë dhe banorë të zonës së Njesisë Muhurr. Fjalën përshëndetëse pas kryetarit e mbajti deputetja Selami dhe zoti Sava. Të pranishëm në dëgjese publike

Gjatë dëgjesës publike në Njësine Administrative Muhurr u evidentuan problematika të përsëritura në shumicën e fshatrave, ku në fokus ishin: mungesa ose turbullimi i ujit të pijshëm, nevoja për ujë vaditës dhe rehabilitim kanalesh; gjendja e rënduar e rrugëve rurale që kërkojnë asfaltim, sistemim me zhavorr ose hapje me fadromë; problemet e kanalizimeve të ujërave të zeza; ndërprerjet e shpeshta të energjisë elektrike; si dhe përmirësimi i shërbimit të mbetjeve. Kërkesat kryesore të komunitetit lidhen me përmirësimin e infrastrukturës rrugore, sistemimin e ujit të pijshëm e vaditës dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve bazë. Kryetari theksoi se prioritet për vitin e ardhshëm mbeten: Ujësjiellësi i Rreth-Kalës, Unaza e Muhurrit dhe ujësjiellësi i fshatit Vakuf si dhe projektet që janë në zhvillim e sipër.



(Foto gjate takimit ne njësinë Muhurr)

Nevojat sipas banorëve në njësinë administrative Muhurr.

Shqarth – Haxhi Mani

Nënvizoi problematikat e erozionit dhe vështirësive në qarkullim gjatë stinës së dimrit.

Nevojat: Hapja dhe rehabilitimi i rrugës me fadromë; mbjellja e pemëve për të frenuar rrëshqitjen e tokës; stabilizimi i furnizimit me energji elektrike, pasi ndërpritet sa herë ka reshje ose mot të keq.

Kryetari: Problemet do të evidentohen në planin e punimeve të mirëmbajtjes së infrastrukturës rurale.

Rreth-Kale – Asllan Laçi

Theksoi nevojat për përmirësimin e infrastrukturës bujqësore dhe rrugore.

Nevojat: Rikonstruksioni i kanalit vaditës; asfaltimi i rrugës deri në fund të fshatit; sistemimi i një segmenti prej 30–40 metrash kanali që përmbyt tokat (rreth 50 dynymë); stabilizimi i furnizimit me energji elektrike.

Kryetari: Ujësjiellësi i Rreth-Kalës mbetet prioritet kryesor. Problematikat e tjera do të trajtohen sipas mundësive dhe planifikimeve buxhetore.

Fushë Muhurr – Fatrilsmija

Parashtoi shqetësime që lidhen drejtpërdrejt me cilësinë e jetesës dhe zhvillimin bujqësor.

Nevojat: Kanalizimet e ujërave të zeza janë problem serioz që pengojnë edhe ujitjen; uji i pijshëm ndotet dhe turbullohet gjatë reshjeve; kërkohet ndërtimi i një prite betoni nga kompania italiane për mbrojtje të burimit.

Kryetari: Problemi i kanalizimeve është i pranishëm në të gjitha njësitë, përfshirë dhe qytetin. Po shqyrtohet një zgjidhje e përbashkët në nivel bashkie.

Vaj-Mdhej – Myrtezan Balliu / Kreshnik Pira

Përkruan situatën e vështirë të fshatit për shkak të mungesës së infrastrukturës bazë.

Nevojat: Rruga është në gjendje të rënduar dhe kërkon ndërhyrje emergjente; mungesë totale e ujit të pijshëm; kërkohet vendosja e 3 tubave (2 tubacione 2-metroshe dhe 1 tub 1-metërsh) për devijimin e ujërave të rrugës; kërkohet mbledhja javore e mbeturinave.

Kryetari: Tubat mund të tërhiqen në bashki. Problemi i rrugës dhe ujit do të vlerësohet në terren.

Hurdhë Muhurr – Petrit Deva

Theksoi rëndësinë e ujitjes dhe qarkullimit brenda fshatit.

Nevojat: Kanal vaditës 2.5 km; përfundimi i Unazës së Muhurrit; stabilitet i energjisë elektrike pasi dritat ndërpritën shpesh.

Kryetari: Punimet në Unazën e Muhurrit janë prioritet. Për kanalin do të sigurohen tubat e nevojshëm.

Muhurr – Hysen Mikli

Riktheu vëmendjen te problematikat infrastrukturore të përmendura edhe nga banorë të tjerë.

Nevojat: Përfundimi i Unazës së Muhurrit; kanal vaditës 2.5 km; zgjidhja e ujërave të zeza dhe ndotjes së ujit të pijshëm gjatë reshjeve.

Kryetari: Bashkia po punon intensivisht në Njësinë Muhurr. Tuba për kanalin do të sigurohen dhe punimet do të vazhdojnë sipas mundësive.

Përmbledhje e kërkesave nga degjësat publike Njësia Kastriot, te vitit 2025

Përmbledhje e kërkesave nga degjesat publike te vitit 2025																			
Nr	Njesia Administ rative	Data zhvillimit te degjeses publike	Diskutanti (Emer e Mbiemer)	Fshati (qe perfshin diskutimin)	Cfare kerkohet	Asfaltim ruge	Rregullim ruge me kalldrem	Uje I Pishem	Uje vadites	Ndricim RrUGOR	Sistemim i Ujrave te zeza	Pastrim Kanalesh vaditese	Sistemim mbeturinash	Problem me energjine	Shkolla, njesi shendetesore	Punetor mirembajtje	Pastrim I Liqepit	Prita per permbytjet	Pastrim Varrezash
1	Muhurr	10.10.2025	Abdullah Hoxha	Muhurr		1	1	1	1										
2	Muhurr	10.10.2025	Haxhi Mani	Shqarth			1							1				1	
3	Muhurr	10.10.2025	Asllan Laci	Rreth Kale		1		1				1		1					
4	Muhurr	10.10.2025	Fatri Ismija	Fushe Muhurr				1			1			1					
5	Muhurr	10.10.2025	Myrtezan Balliu	Vaj MDHEJ		1					1			1					
6	Muhurr	10.10.2025	Kreshnik Pira	Vaj MDHEJ			1		1		1			1					
7	Muhurr	10.10.2025	Petrit Deva	Hurdhe Muhur		1			1					1					
8	Muhurr	10.10.2025	Hysen Mikli	Muhurr		1			1					1					
9	Muhurr	10.10.2025												1					
10	Muhurr	10.10.2026																	
Totali kërkesave							2	3	4	3	0	2	1	0	6		0	0	

Gjatë dëgjësës publike në Njësinë Administrative Luzni u evidentuan problematika të përsëritura në disa fshatra, kryesisht të lidhura me gjendjen e rrugëve, furnizimin me ujë të pijshëm, mungesën e ujit vaditës, cilësinë e ujësjellësit, nevojën për rehabilitim kanalesh, si dhe stabilitetin e energjisë elektrike. Banorët kërkuar veçanërisht përmirësimin e infrastrukturës rrugore, zgjidhjen e ujit të pijshëm dhe vaditës, përforcimin e shërbimeve bazë dhe ndihmë në shërbimin shëndetësor. Kryetari theksoi se rruga e Hoteshit, përfundimi i rrugës së Katundit të Ri dhe investimet në ujësjellësin e Hoteshit dhe Arapit të Poshtëm mbeten prioritetet kryesore të vitit të ardhshëm.



(Foto gjatë takimit në njësinë Luzni)

Nevojat sipas fshatrave në Njësinë Administrative Luzni

Lishan i Epërm – SadikKurti

Përshkruan situatën e vështirë të fshatit për shkak të mungesës së infrastrukturës bazë. Falenderon punën e Bashkisë në Njësinë Administrative Luzni.

Nevojat: Gjendja e rrugës paraqitet e rënduar dhe kërkohet ndërhyrje të paktën në një segment të saj. Nëse është mundësia që të ndërhyhet sepse kemi nevojë. Ruajtja dhe sigurimi i furnizimit të qëndrueshëm me ujë të pijshëm; përmirësimi i cilësisë së ujësjellësit dhe shmangia e defekteve dhe abuzimeve që bëhen tek ujësjellësi.

Arap i Poshtëm / Arap i Epërm – Besim Mera

Nevojat: Përqendrim i investimeve në tre fshatrat kryesorë të zonës — Arap i Poshtëm, Arap i Epërm dhe Lishan i Poshtëm — ku problemet e rrugëve dhe ujit janë më të theksuara.

Kryetari: Furnizimi me ujë në Lishan ka qenë i stabilizuar vitin e fundit. Ujin e kemi marrë por nuk e kemi lënë Lishanin e Poshtëm pa ujë dhe këtë e dimë të gjithë. Rruga ka probleme, e di dhe jam koshient por do të ndërhyhet pjesë-pjesë, duke nisur nga segmentet më emergjente. Pas Hoteshit në njësinë tuaj mbetet vetëm Lishani i Epërm dhe normalisht do i vijë radha shumë shpejt. Buxheti do të orientohet sipas prioriteteve të komunitetit, duke nisur nga fshatrat me nevojat më urgjente.

Lishan i Poshtëm – Dalip Prethi

Theksoi problematikat me ujin e pijshëm. mos menaxhimi si duhe dhe zgjerimi i rrugës së fshatit.

Nevojat: Zëvendësimi i tubave të dëmtuar të ujësjellësit, pasi në disa pika plasjet krijojnë humbje të mëdha; Është e nevojshme zgjerimi minimal i rrugës me zhavorr anash për të mundësuar qarkullimin e sigurt të mjeteve. Në rrugë nuk i merr dy mjete lirisht.

Kryetari: Tubat do të zëvendësohen sipas nevojës dhe situatës së terrenit. Ju lutem na kontaktoni për çdo problem me tubat sepse ju ndihmojmë direkt. Për rrugën të mbarojmë njëherë këto që fshatra qëskanë fare rrugë dhe zgjerimi do të bëhet, pa merak.

Lishan i Poshtëm – Gezim Murati

Nevojat: Rruga është në gjendje shumë të vështirë dhe kërkon ndërhyrje urgjente (të paktën 20 makina zhavorr dhe një rul); mungesë e ujit të pijshëm dhe vaditës.

Kryetari: Zona është në projektin e përbashkët me Hoteshin. Tuba do të sigurohen pa diskutim.

Katund i Ri – Lagjia Dede – Belrim Dedja

Theksoi nevojat për përmirësimin e furnizimit me ujë të pishëm në lagjen e tij, nevoja për sistemim të infrastrukturës së brendshme.

Nevojat: Mungesë e ujit të pijshëm është problem në lagjen time. Lagjia Dede. Ka mungesë të ujit vaditës; rruga dhe infrastruktura e brendshme e lagjes kërkojnë ndërhyrje; nevojiten rreth 500 metra tub për furnizim me ujë të pishëm në zonën ku unë banoj. Brënda mundësive sepse e di që nuk bëhet cdo gjë me laps.

Kryetari: Tubat do të sigurohen nga bashkia. Punimet do të ecin me faza, duke u fokusuar te çdo lagje sipas mundësive buxhetore.

Arap i Poshtëm – Besnik Toci

Përshkruan situatën e vështirë të fshatit për shkak të mungesës së infrastrukturës bazë.

Nevojat: Ndërhyrje në rrugën e Lishanit, përfundimi i segmentit deri në fund të fshatit; investim në rrjetin e ujësjellësit të Hoteshit, Nikollës dhe Lishanit; stabilizimi i linjave elektrike, pasi telat shpesh prekin tokën; përmirësim i ujit të pijshëm; pastrim i kanalit vaditës 3 km; mungesë e infermieres në zonë. Të gjithë zona nuk ka njëinfermjere. Ne jemi pensionista dhe duhet një infermiere.

Kryetari: Arapi i Poshtëm është pjesë e projektit të përbashkët me Hoteshin. Segmenti i rrugës do të realizohet patjetër. Për energjinë do të kontaktohet OSHEE, ndërsa për shërbimin shëndetësor do të kërkohet mbështetje nga Spitali.

Katund i Ri – DemirColja

Përshkruan situatën problematike me ujësjellësin dhe me energjinë elektrike. Nevojë për ndërhyrje në disa lagje të Katundit të Ri, Luzni,.

Nevojat: Përmirësim i shërbimit të ujësjellësit dhe reagim më i shpejtë në raste defektesh; ndërhyrje në kanalet vaditëse. Duhet të pastrohen sepse jemi njerëz pensionista që nuk kemi fuqi të pastrojmë, sidomos daljet me nevojë cementimi; Është nevojë urgjente zgjerim i rrugëve në Late, Police dhe Dede, për të lehtësuar lëvizjen.

Kryetari: Këto lagje do të trajtohen sipas programit të punimeve bashkiake. Bashkëpunimi me komunitetin mbetet i rëndësishëm për zgjidhjen e tyre. Sipas mundësive do ndërhyjmë nëcdo lagje. Vetëm dua që të kemi durim dhe bashkëpunim me njëri tjetrin.

Hotesh – DorSkuka

Përshkruan situatën problematike të rrugës, ujit vaditës dhe atij tëpishëm nëHotesh.

Nevojat: Rruga është emergjente në të gjithë segmentin prej 6 km; mungesë e theksuar e ujit të pijshëm; nevojë për kanal vaditës, vendosjen e 4 tubave dhe një pusetë 50 cm për kalimin e ujit. Këto janë problematikat që shqetësojnë fshatin tonë.

Kryetari: Rruga e Hoteshit do të asfaltohet. Asfalti është në dorë të bashkisë dhe do të realizohet. Çështja e ujësjellësit nuk varet tërësisht nga bashkia, por shqetësimi do të përcillet për zgjidhje.

Përmbledhje e kërkesave nga degjësas publike të vitit 2025																			
Nr	Njësia Administrative	Data zhvillimit të degjësës publike	Diskutanti (Emër e Mbiemër)	Fshati (që përfshin diskutimin)	Cfare kerkohet	Asfaltim rruge	Rregullim rruge me kalldrem	Uje i Pishem	Uje vadites	Ndricim RrUGOR	Sistemim i Ujrave te zeza	Pastrim Kanalesh vaditese	Sistemim mbeturinash	Problem me energjine	Shkolla, njesi shendetesore	Punetor mirembatje	Pastrim i Liqenit	Prita per permbytjet	pastrim Varrezash
1	Luzni	4.11.2025	Sadik KURTI	Lishan i Eperem			1	1	1			1							4
2	Luzni	4.11.2025	Besim MERA	Arap i poshtem					1			1							2
3	Luzni	4.11.2025	Dalip Prethi	Lishan i Poshtem			1	1											2
4	Luzni	4.11.2025	Gezim Murati	Fushe Muhurr			1	1	1										3
5	Luzni	4.11.2025	Blerim Dedja	Lagjia Dede			1	1	1			1		1					5
6	Luzni	4.11.2025	Besnik TOCI	Arap i Poshtem		1		1				1		1	1	1			6
7	Luzni	4.11.2025	Demir Colja	Katund i RI			1	1	1			1							4
8	Luzni	4.11.2025	Dori Skuka	Hotesht		1		1	1					1					4
9	Luzni	4.11.2025													1				0
10	Luzni	4.11.2025																	0
totali kërkesave							1	5	7	6	0	0	5	0	3		0	0	27

Përmbledhje e kërkesave nga degjësas publike Njësia Luzni, të vitit 2025


Dëgjesa Publike – Njësia Administrative MELAN

Data: **28 Tetor 2025**

Ora: **13:00**

Vendi: **Njësia Administrative Melan. (Lakali pranë shkollës Melan)**

Takimi në njësinë Administrative Melan ishte një takim që kishte shumë interes. Të pranishëm në takim ishte kryetari i Bashkisë Diber. Gjatë dëgjësës publike në Njësinë Administrative Melan u evidentuan problematika të ndryshme në disa fshatra, kryesisht të lidhura me gjendjen e rrugëve, furnizimin me ujë të pijshëm, kanalizimet e ujërave të zeza, mungesën e ndriçimit rrugor, si dhe nevojën për përmirësim të infrastrukturës së varrezave dhe objekteve publike. Banorët kërkuar veçanërisht përmirësimin e rrugëve, pastrimin e kanaleve vaditëse dhe sigurimin e ujit për vaditje dhe konsum. Kryetari theksoi se për shumë çështje, bashkëpunimi i komunitetit është i domosdoshëm, duke nënvizuar se nuk mund të zgjidhen të gjitha problemet vetëm nga bashkia.



(Foto gjate takimit ne njësinë Luzni)

Nevojat sipas fshatrave në Njësinë Administrative Melan.

Melan – Isni Myftiu

Përshkruan situatën problematike në kanalizimet e zeza dhe sistemin vadtës.

Nevojat: Kanalizimet e ujërave të zeza janë problematike. Po ashtu edhe varrezat e fshatit duhet të rregullohen ndoshta në bashkëpunim me banorët e zonës. Kanali kryesor vadtës kërkon pastrim dhe ndërhyrje tek liqeni i Melanit. Këto janë problematikat që shqetësojnë fshatin Melan.

Kryetari: Kanalizimet janë një problem i madh kudo. Bashkëpunimi i komunitetit është i domosdoshëm për zgjidhjen e tyre.

Trepçë – Bilal Shqefni

Problematikë të gabinës elektrike, ndriçim rrugor dhe pengesa në rrugë kryesore.

Nevojat: 200 metra rrugë duhet të ndërhyhet; gabina elektrike është shembur dhe paraqet rrezik; kërkohet ndriçim rrugor nga liqeni deri në fshat dhe zgjidhja e pengesave në rrugë.

Kryetari: Rruga 200 metra do të shqyrtohet për zgjidhje; pengesat nuk mund të trajtohen sepse rruga është e ARSH-së. Problematikën e gabinës elektrike do ta shqyrtojmë me ekipin e OSHE Dibër.

Rabdisht – RamadanShahini

Theksoi rëndësinë e investimit në fshatin Rabdisht pasi është pjesë e projektit të 100 fshatrave.

Nevojat: Rruga hyrëse 150 metra duhet të bëhet; kanalizimet e ujërave të zeza janë një problem shëndetësor dhe turistik; shkolla nuk ka rrethim dhe banjo, xhamat janë të thyera. Duhet të bëhen më shumë investime sepse është fshat turistik.

Kryetari: Rruga deri tek shkolla është asfaltuar dhe janë bërë pritat; Nuk mund të thuash që nuk është investuar në zonën e Rabdishtit. U asfaltua rruga që ka qenë një problem shumë i madh. Sigurisht investimet do të vazhdojnë sipas buxhetit dhe projektet për Rabdishtin do të implementohen.

Begjunec – ElezRoshi / Ben Raza

Nevojat: Nuk ka ndriçim rrugor; ndërhyrje emergjente tek liqeni për vaditje; kanali kryesor nuk funksionon që nga 1997; rruga 500 metra nga varrezat deri në Kuplon kërkon sistemim.

Kryetari: Ndërhyrjet tek liqeni janë realizuar; komuniteti duhet të bashkëpunojë për mirëmbajtjen e kanalit.

Pjeqe – Sali Sula / Urim Tuka / Shefki Sula/ Petrit Mani

Nevojat: Kanali vaditës është prishur nga firma e rrugës; rrezik për fëmijët në hyrje të rrugës kryesore; mungesë e ujit të pijshëm dhe vaditës; depozita e ujit e vogël; nevojë për pusete dhe rregullim të përdorimit të ujit.

Uji që shkon në Pjece humbet; nevojitet lidhja e 200 metrave tub për të shpërdoruar ujin; infermierja e fshatit ka nevojë për ambient adekuat; kanalizimet e ujërave të zeza dhe dritat elektrike kanë nevojë për ndërhyrje; sugjerim për vendosjen e pikezusave me tuba betoni në rrugën e Gjurallarëve.

Kryetari: Rruga e hyrjes për Pjeqe do të hapet; uji do të rregullohet me çdo mundësi; infrastruktura për ujë të pijshëm do të përmirësohet sipas mundësive. Ujësjellësi nuk është në varësinë e bashkisë, por problematikat do të përcillen dhe do të zgjidhen me përfshirjen e komunitetit.

Ilnicë – Vis Shehu

Nevojat: Kanalizimet e ujërave të zeza dhe rruga kërkojnë ndërhyrje; nevojitet përmirësim i shërbimeve bazë për fshatin.

Kryetari: Pas takimit do të shkojmë në Ilnicë për të vlerësuar situatën dhe për të nisur ndërhyrjet konkrete.

Trenë – Pellumb Fisniku

Theksoi rëndësinë e sistemimit të kanaleve të zeza në zonë.

Nevojat: Uji është stabil; kërkohen dy degëzime të tubacioneve në rrugë; kanalizimet e ujërave të zeza janë problem.

Kryetari: Problemet e kanalizimeve do të trajtohen; ndërhyrjet e tjera do të bëhen sipas mundësive.

Përmbledhje e kërkesave nga degjësat publike Njësia Melan, te vitit 2025


Përmbledhje e kërkesave nga degjësas publike te vitit 2025																			
Nr	Njesia Administ rative	Data zhvillimit te degjeses publike	Diskutanti (Emer e Mbiemer)	Fshati (qe perfshin diskutimin)	Cfare kerkohet	Asfaltim rruge	Rregullim rruge me kalldrem	Uje I Pishem	Uje vadites	Ndricim RrUGOR	Sistemim I Ujrave te zeza	Pastrim Kanalesh vaditese	Sistemim mbeturinash	Problem me energjine	Shkolla, njesi shendetesore	Punetor mirembajtje	Pastrim I Liqenit	Prifa per permbytjet	Pastrim Varrezash
1	Melan	28.10.2025	Isni Myftiu	Melan				1	1								1		
2	Melan	28.10.2025	Bilal Shqefni	Trepce		1								1					
3	Melan	28.10.2025	Ramadan Shahini	Rabdisht			1				1				1				
4	Melan	28.10.2025	Arben Raza	Begjunec			1		1								1		
5	Melan	28.10.2025	Elez ROSHI	Begjunec			1							1					
6	Melan	28.10.2025	Sali Sula	Pjece				1	1										
7	Melan	28.10.2025	Urim Tuka	Peke				1	1					1	1				
8	Melan	28.10.2025	Vis Shehu	Ilnice		1	1						1	1	1				
9	Melan	28.10.2033	Pellumb Fisniku	Trene						1									
10	Melan	28.10.2034																	
Totali kërkesave							1	4	3	4	1	1	0	1	4		2	0	21

Dëgjesa Publike – Njësia Administrative TOMIN (Qendër)

Data: 5 Nëntor 2025

Ora: 13:00

Vendi: Vend takimi Lokal Hoxha pranë Njesise administrative Tomin, fshati Tomin Dibër



(Foto gjatë takimit në njësinë Tomin)

Takimi në Njësinë Administrative Tomin ishte një takim me pjesëmarrje dhe interes të lartë nga banorët. Të pranishëm në takim ishte kryetari i Bashkisë Dibërz. **Rahim Spahiu**, deputetja znj. **Alma Selami** dhe administratori i njësisë **Luan Kola**.

Gjatë dëgjësës publike u evidentuan problematika të ndryshme në disa fshatra të Tomin, kryesisht të lidhura me gjendjen e rrugëve, furnizimin me ujë të pijshëm, kanalizimet e ujërave të zeza, mungesën e ndriçimit rrugor, si dhe nevojën për ndërhyrje në kanalet vaditëse dhe pastrimin e tyre.

Që në nisje të takimit kryetari Spahiu theksoi pikat ku do tëpërqëndrohet kryesisht buxheti i këtij viti në Njësinë Administrative Tomin. Rruga e Kabe, Rruga e Shimcanit, Një shtresë e segmenti Rashnapojë-Brezhdan, Rruga dytësore nëTomin, Rikonstruksioni total i shkollës 9v vjeçare Tomin et.

Banorët kërkuar ndërhyrje të menjëhershme, ndërsa kryetari theksoi se për shumë prej çështjeve bashkëpunimi i komunitetit është i domosdoshëm, pasi nuk mund të zgjidhen të gjitha problemet vetëm nga bashkia.

Nevojat sipas fshatrave në Njësinë Administrative Tomin.

Ushтеленxë – (Haki ...)

Theksoi rëndësinë ndërhyrjes në sistemimin e rrugës së asfaltuar dhe problematika e nje muri.

Nevojat: Rruga e fshatit nuk ka pasur ndërhyrje që nga asfaltimi i parë; ka zona ku kërkohet asfaltim i pjesshëm; muri rreth 15 metra ka zënë rrugën; një shtëpi është në rrezik shembjeje.

Kryetari: Ushтеленxa ka qenë një ndër fshatrat e parë me rrugë të shtruar. Duhet bashkëpunim mes banorëve dhe jo hedhje fajit; problemet zgjidhen duke bashkëpunuar së bashku.

Pilafe – Krveplaku i fshatit Pilafe.

Problematika kryesore të lagjes së Kabes dhe Pilafes.

Nevojat: Kanalet e zeza janë burim infeksioni; rruga e Kabëve (që kryetari tha se do bëhet); asfaltimi i 200 metrave rrugë nga Shuip Cenga deri tek varrezat; rregullimi i murit pranë varrezave; kanali vaditës Tomin–Pilafe kërkon pastrim; nevojiten 800 m tub për ujin në Kabë; segmenti nga Nezirlsufi tek Përparim Muda është shumë i dëmtuar.

Kryetari: Kanalet e zeza varen nga Ujësjellësi, që do funksionojë me vetëadministrim. Procedurat për Pilafën (varrezat dhe kanalizimet) kanë përfunduar. Kanali vaditës do pastrohet dhe punimet do nisin sipas projektit. E thash dhe për rrugën e fshatit Kabe që në fillim të bisedës.

Shimcan – Arben Torba

Problematika kryesore është rruga dhe ndërhyrje në çështjen e ujit vaditës.

Nevojat: Rruga e Shimcanit është një problem emergjent; liqeni ka nevojë për ndërhyrje; ujërat e zeza janë problem i madh; nevojë për zgjidhjen e çështjes së urës së fshatit.

Kryetari: Rrugës së Shimcanit i ka ardhur koha të bëhet, pasi është fshat pranë qytetit dhe nuk ka logjikë të mbetet pa ndërhyrje. Për liqenin, investimi duhet bërë me kujdes dhe me studim teknik.

Brezhdan – Lagjia Kallcisht

Fokusohet tek mungesa e ujit të pijshëm.

Nevojat: Në lagjen Kallcisht janë 4 familje janë pa ujë të pijshëm; rruga është dëmtuar nga punimet e ujësjellësit; kërkohet mundësi për ta marrë ujin nga zona poshtë (Gani Salkurti).

Lagjia Demozete: Falenderim për punët e kryera; kërkohet ndriçim rrugor; kanalizime të ujërave të zeza; rruga që të çon tek tokat kërkon ndërhyrje.

Kryetari: Askujt nuk do t'i mungojë uji. Do gjendet zgjidhja teknike më e mirë. Punimet vazhdojnë deri në Kallcisht. Kërkesat do të trajtohen çdo ditë.

Selane – Beqir Demiri

Fokusohet tek mungesa e ujit të pijshëm.

Nevojat: Furnizim i pamjaftueshëm me ujë të pijshëm; tubacionet duhet rishikuar.

Kryetari: Çështja do të trajtohet nga inxhinierët dhe do gjendet zgjidhja më e përshtatshme.

Përmbledhje e kërkesave nga dëgjuesat publike Njësia Tomin, te vitit 2025



Përmbledhje e kërkesave nga degjuesat publike te vitit 2025																				
Nr	Njesia Administ rative	Data zhvillimit te degjeses publike	Diskutanti (Emer e Mbiemer)	Fshati (qe perfshin diskutimin)	Cfare kerkohet	Asfaltim rruge	Rregullim rruge me kalldrem	Uje i Pishem	Uje vadites	Indricim RrUGOR	Sistemim i Ujrave te zera	Pastrim Kanalesh vaditese	Sistemim mbeturinash	Problem me energjine	Shkolla, njesi shendetesore	Punetor mirembatje	Pastrim i Liqenit	Prita per pormbytjet	Pastrim Varrezash	
1	Tomin	05.11.2025	Kr. Pilafe	Pilafe			1	1	1		1	1	1				1		1	8
2	Tomin	05.11.2025	Kr. Pilafe	Kabe		1			1				1			1				4
3	Tomin	05.11.2025	Haki...	Ushtelenxe		1		1	1		1									4
4	Tomin	05.11.2025	Arben Torba	Shimcan		1		1	1								1			4
5	Tomin	05.11.2025	Kr Brezhdan	Lagjia Kallcisht				1	1											2
6	Tomin	05.11.2025	Kr Brezhdan	Demozete			1			1	1		1							4
7	Tomin	05.11.2025	Beqir Demiri	Selane				1												1
8	Tomin	05.11.2025	Mazllum Elezi	Bahute		1														1
9	Tomin	05.11.2025	Samet Torba	Shimcan		1			1									1		3
10	Tomin	05.11.2025																		
totali kërkesave						2	2	5	6	1	3	1	3	0			3	0		26

Dëgjesa Publike – Njësia Administrative Zall Reç

Data: 14 Nëntor 2025

Ora: 11:00

Vendi: Vend takimi Zall Reç



Takimi nisi me mikpritjen e banorëve në këtë zonë të largët të Dibrës. Kryetari i Bashkisë Dibër z.Rahim Spahiu u ul në një tavolinë me banorët për të dëgjuar problematikat e tyre. Për shkak se banorët janë më të paktë në numër, dëgjesa u zhvillua në formë bashkëbisedimi. Zona e Zall Recitështë një nga zonat më të largëta të Bashkisë Dibër.

Para nisjes së diskutimeve, kryetari urdhëroi administratorin të komunikonte me fadromistin për sistemimin e një segmenti të rrugës dhe foli me drejtorin e OSHEE për rregullimin e kabinës elektrike të zonës. Ai siguroi të gjithë të pranishmit që

Nevojat sipas fshatrave në Njësinë Administrative Zall Rec.

Shkëlqim Troci (Zall Reç)

“Për ne problemi kryesor është energjia elektrike. Kam dy fëmijë me arsim të lartë dhe kërkoj mundësi punësimi. Po ashtu, kam nevojë për 4 tuba për një kanal.”

Kryetari: “Tubat i merr sot te shërbimet. Për çështjen e punësimit do e shqyrtojmë. Me drejtorin e OSHEE sapo fola dhe më konfirmoi se problematika e kabinës do ndiqet nga firma.”

Selim Elezi (Zall Reç)

“Kane ardhur për matjen e tokave, por mua nuk m’i kanë matur. Jam i sëmurë, nuk kam të ardhura dhe kërkoj një mundësi punësimi për djalalin e djalit.”

Kryetari: “Do e ndjekim çështjen. Administratori e ka shënuar dhe do verifikojmë situatën.”

Petrit Prenci (Bardhaj Reç)

“Faqja zyrtare e Bashkisë Dibër nuk është e përditësuar. Ne duam të dimë çfarë bëhet. Kam vajzën infermiere dhe dua ta punësoj, por jo në Tiranë—më keni mbyllur derën.”

Kryetari: “Është detyra jonë të ofrojmë shërbimin e duhur për çdo qytetar, edhe pse nuk kemi shkop magjik. Dyert e Bashkisë kanë qenë dhe do të jenë të hapura. Por sot jemi këtu për problemet e zonës, jo të Tiranës.”

Lagjia e Uklalëve

Banorët e Elezetit dhe Uklalëve kanë hapur vetë rrugën me kontribut financiar dhe fizik, pa pritur askënd.

Kryetari: “Mundësitë janë të pakta dhe buxheti është i kufizuar. Vitin e ardhshëm investimi shkon deri te ura e Zall Dardhës. Për rregullim banesash, ejani në dhjetor në bashki kur të hapen aplikimet dhe stafi do t’ju ndihmojë.”

Përmbledhje e kërkesave nga dëgjuesat publike Njësia Zall REC, te vitit 2025

Përmbledhje e kërkesave nga degjesat publike te vitit 2025																			
Nr	Njesia Administ rative	Data zhvillimit te degjeses publike	Diskutanti (Emër e Mbiemër)	Fshati (qe perfshin diskutimin)	Cfare kerkohet	Asfaltim rruge	Rregullim rruge me kalldrem	Uje i Pishem	Uje vadites	Ndricim RrugOR	Sistemim i Ujrave te zeza	Pastrim Kanalesh vaditese	Sistemim mbeturinash	Problem me energjine	Shkolla, njesi shendetesore	Punetor mirembatje	Pastrim i Liqenit	Prita per permytjet	Pastrim Varrezash
1	Zall Rec	14.11.2025	Selim Elezi	Zall Rec			1	1	1		1	1	1	1	1	1			9
2	Zall Rec	14.11.2025	Petrit Prenci	Bardhaj Rec			1		1			1	1	1	1	1			7
3	Zall Rec	14.11.2025	Shkelqim Troci	Zall Rec					1			1		1					3
4	Zall Rec	14.11.2025	kryeplaku	L. Uklaleve			1					1		1					2
5														1					0
6																			0
7																			0
8																			0
9																			0
10																			0

Dëgjesa Publike – Njësia Administrative Zall Dardhë


Data: 13 Nëntor 2025

Ora: 13:00

Vendi: Në fshatin Zall Dardhë.

Në takimin e Njesisë Administrative Zall Dardhë kishte një numër të madh banorësh të cilët sipas njoftimit ishin mbledhur për të shprehur problematikat që i shqetësojnë. Të pranishëm ishin kryetari i Bashkisë Dibër, Rahim Spahiu, kryetari i këshillit bashkiak **Sokol Sava** dhe një pjesë e satfit të Bashkisë. Takimi u hap me përshëndetjen e Kryetarit të Bashkisë Dibër, **Rahim Spahiu** i cili falënderoi pjesëmarrësit dhe prezantoi një përmbledhje të investimeve të kryera gjatë vitit 2025 në Njësine Administrative Zall Dardhë.





Nevojat sipas fshatrave në Njësinë Administrative Zall Dardhë.

Shën Lleshën– Bashkim Cani

Fokusohet tek mungesa rrugës dhe energjisë elektrike

Nevojat: Furnizim i pamjaftueshëm energji elektrike, problem furnizimi dhe sa herë frynë era është problem; Edhe rruga duhet shikuar pasi jemi një zonë mjaftë e madhe.

Kryetari: Për sa i përket rrugës të paktën deri në Zall Dardhë besoj do të bëhet. Për OSHE do kemi diskutim me drejtuesit e OSHE DIBËR.

Ferit HOXHA- Zall DARDHË

Fokusohet tek mungesa e një kanali vaditës

Nevojat: Kanali vaditës, për tu pastruar dhe për tu sistemur. Rruga është shumë e rëndësishme për vendin. Po ashtu edhe për ujë të pishëm kemi nevojë.

Kryetari: Do ta ndjekë Agroni pjesën e kanalit. Për rrugën e thash që do bëjmë të pamundurën ta sjellim të paktën deri në Zall Dardhë.

Mexhit Sula- Zall Dardhë

Fokusohet tek mungesa e një kanali vaditës

Nevojat: 300 M kanal duhet ta bëjë administratori.

Vehap HASA-Zall Dardhë

Fokusohet tek infrastruktura rrugore

Nevojat: 3-4 orë në ditë të rri punojësi i mirëmbatjes. Rruga me pak mirëmbatje nuk është keq. Vetëm të mbushë gropat punojësi që paguhet dhe kaq. Me zhavorr, pastaj kur të kesh mundësi me asfalt është gjë shumë e mirë.

Kryetari: Të siguroj për këtë. Qëllimi jonë është që të bëjmë realitet asfaltimin e rrugës.

Rakip Shira- Zall Dardhë

Fokusohet tek problematikat me shkollën.

Nevojat: Drutë e zjarrit në shkollë kanë ardhur por nuk janë ato që bëjnë punë. Janë të lagtë dhe nuk ndizen. Dritaret e shkollës janë të thyera dhe veshtirë të bëjmë mësim.

Kryetari: E di problemin. Brënda ditës së nesërme vijnë drutë e thatësic u takon,

Përmbledhje e kërkesave nga dëgjesat publike Njësia Zall Dardhë te vitit 2025

Përmbledhje e kërkesave nga dëgjesat publike te vitit 2025													
Nr	Njesia Administrative	Data zhvillimit te degjeses publike	Diskutanti (Emer e Mbiemer)	Fshati (qe perfshin diskutimin)	Cfare kerkohet	Asfaltim rruge	Rregullim rruge me kalidrem	Uje i Pishom	Uje vadites	Ndricim RRUGOR	Sistemin i Ujrave te zeza	Pastrim Kanalesh vadites	Sistemin mbeturinash
1	Zall Dardhe	14.11.2025	Bashkim Cani	Shen lleshen			1	1	1			1	1
2	Zall Dardhe	14.11.2025	Ferit HOXHA	Zall Dardhe			1		1			1	
3	Zall Dardhe	14.11.2025	Mexhit Sula	Zall Dardhe					1				
4	Zall Dardhe	14.11.2025	Vehap Hasa	Zall Dardhe		1							
5	Zall Dardhe	14.11.2025	Rakip Shira	Zall Dardhe									1
6													
7													
8													
9													
10													
Totali kerkesave:						0	2	1	3	0	0	3	0
												0	0
													10


Dëgjesa Publike – Njësia Administrative ARRAS

Data: 14 Nëntor 2025

Ora: 11:00

Vendi: Lokal LUSHA, Arras.

Takimi në njësinë Administrative Arras u mbajt në datën 14 Nëntor 2025. Dëgjesa Publike hap me përshëndetjen e Kryetarit të Bashkisë Dibër, **Rahim Spahiu** i cili falënderoi pjesëmarrësit dhe prezantoi një përmbledhje të investimeve të kryera gjatë vitit 2025 në Njësinë Administrative Arras. Disa nga punët e bëra në këtë njësi, rikonstruksion i shkollave, GrykëNokë, Arras, Mustafe dhe qëndrës shëndetësore. Aksi 2 km që të lodh me rrugën e Lurës. Jemi në plan të bëjmë rrugën deri në Kodër Leshe, në plan të afërt është rruga e Sinës deri tek MUZEU, nëMustafe do të kemi një rehabilitim rruge.



Nevojat sipas fshatrave në Njësinë Administrative Arras.

Mazllum SAVA, Han SAVA, Haki SHEHU- Mustafe

Fokusohet tek problematikat e fshatit

Nevojat: Rruga e fshatit është shumë keq. Ka nevojë për ujë të pishëm, ujë vaditës, për sistemim të energjisë elektrike. Shkolla që u bë duhet të mirëmbahet. Jemi të zhgënjyer nga punët e pabëra në fshatin Mustafë. Rruga është vetëm 5 km. Rruga e Mustafes dhe Lashkizës janë me të vërtetë problematike. Nuk kemi as ujë të pishëm as dritë.

Kryetari: Do bëjmë të pamundurën që ta sistemojmë rrugën. Selishta dhe rruga juaj ka ngel por u thash që do bëjmë të pamundurën.

Mehmet KOVACI, Shkëlzen Bardhi - Sinë e Epërme

Këmbëngul që të bëhet rruga e SINËS.

Nevojat: Shpresoj që të bëhet rruga e Sinës, nuk e di a është mundësia që të bëhet pak më sipër muzeut sepse janë banorë të cilët kanë nevojë. Po bëni rrugë ku nuk ka njerëz dhe po lini fshatra që janë pa rrugë.

Kryetari: Deri tek muzeu është 100% e sigurtë. Tani ua thash edhe në fillim që do bëjmë të gjitha me aq mundësi sa kemi. Nuk është cdo gjë me pult. Duhet të kemi pak durim.

Gëzim PANA- Kodër LESHE

Nis me falënderim për kryetarin. Nuk ka ardh asnjë kryetar bashkie që të na dëgjojë hallet tona. E dimë se ka shumë punë për të bërë në komnën tonë. Por duhet bashkëpunim dhe durim. Është turp i madh për ne si njësi që zihemi me njëri tjetrin në vend se të japim problematikat tona për të mirë të komunitetit. Unë dhe LamShehi kemi hapur respektivisht në zonat tona nga 10 milion lekë rrugë me lekët e familjes tani i bie që ne te ankohe mi?

Lazim KRRASHI- ARRAS

Nevojat janë të mëdha. Para 10 vitesh duhej 2 orë të ikshim në Peshkopi, tani shkojmë për 15 minuta. Sepse kemi asfaltin dhe kemi parë ndryshime. Arrasi nuk është mësic ka qenë. Duhet të jemi më mirënjohës. Unë kaq kam.

Islam SHEHU- MUSTAFE

Nevojat: Jam mirënjohës për punën që është bërë zoti kryetar. Do flas shumë pak. Shtëpia ime është në kufi me Zall Dardhën dhe 1200 metër rrugë në zabel e kam hapur me financat personale të familjes time. Nga ura deri tek shpiadmt. A mund të më ndihmoni ta sistemoj pak sepse është shumë baltë dhe të vijë një inxhinjer i Bashkisë që ta shohë cfarë ka nevojë për mirëmbajtje. Faleminderit

Kryetari: Unë do të vij vetë që ta shoh. Sapo të kem pak kohë të siguroj që do të vij vetëseps. Avash avash u thash dhe më parë që do ti mbyllem të gjitha gjatë problematikat por vetëm dua që të kemi bashkëpunim dhe të kemi mirëkuptimin e njëri tjetrit. Kjo gjë na mungon. Sinqerisht po ju them që aty ku është bërë më shumë punë ka më shumë kërkesa dhe keni të drejtë. Le të jemi pak më mirëkuptues

Përmbledhje e kërkesave nga dëgjesat publike Njësia ARRAS, te vitit 2025

Përmbledhje e kërkesave nga degjësas publike të vitit 2025																				
Nr	Njësia Administrative	Data zhvillimit të degjësës publike	Diskutanti (Emri e Mbiemri)	Fshati (që përfshin diskutimin)	Cfare kërkohet	Asfaltim rrugë	Rregullim rrugë me kalldrem	Ujë i Pishëm	Ujë vaditës	Ndërtim RRUGOR	Sistemi i Ujërave të zeza	Pastrim Kanalesh vaditëse	Sistemi mbeturinash	Probleme me energji	Shkollat, njësi shëndetësore	Punëtor mirëmbajtje	Pastrim i Liqenit	Prita për përmblytjet	Pastrim Varrezash	
1	Arras	14.11.2025	Mazlami Sava	Mustafë			1	1	1		1	1		1		1				7
2	Arras	14.11.2025	Han SAVA	Mustafë			1	1	1		1	1		1		1				6
3	Arras	14.11.2025	Shkelzen Bardhi	Sinë e eperme			1	1	1		1	1		1		1				4
4	Arras	14.11.2025	Haki Shehi	Mustafë			1	1	1		1	1				1				5
5	Arras	14.11.2025	Lam Shehi	Mustafë			1									1				2
6	Arras	14.11.2025	Lazim KRRASHI	ARRAS										1						1
7	Arras	14.11.2025	Mehmet Kovaci	Sinë e eperme			1													1
8	Arras	14.11.2025	Gezim Pana	Koder Ieshe			1													1
9																				0
10																				0
Totali kërkesave						2	5	1	4	0	2	4	0	3		0	0			21

Dëgjesa Publike – Njësia FUSHË CIDHËN

Data: **14 Nëntor 2025**

Ora: **13:00**

Vendi: **NJËSIA ADMINISTRATIVE FUSHË CIDHËN**

Takimi në njësinë Administrative FushëCidhën u mbajt në datën 14 Nëntor 2025. Dëgjesa Publike hap me përshëndetjen e Kryetarit të Bashkisë Dibër, **Rahim Spahiu** i cili falënderoi pjesëmarrësit dhe prezantoi një përmbledhje të investimeve të kryera gjatë vitit 2025 në Njësinë AdministrativeFushëCidhën. Të pranishëm në këtë dëgjesë publike ishte dhe administratori i zonës po ashtu dhe kryetari i këshillit bashkiak z. Sokol SAVA.

Takimi nis me prezantimin e disa punëve të bëra në këtë njësi dhe me prioritetet që Bashkia dhe Këshilli kanë për këtë njësi për vitin 2026. Do tëbëhën investime deri tek ura e dodës. Segmenti i FushëAlies (me lote). Në fshatin Bllice do të bëhen sistemimi i kanaleve të zeza. E di q ka problem:-shton kryetari rruga e Bllices por do shohim mundësinë që të bëjnë njërisistemim. Edhe shumë problematika të tjera i di por sigurisht që të gjitha këto do të bëhen vetëm nëse ne kemi vetëm pak durim dhe mirëkuptim me njëri tjetrin.

Nevojat sipas fshatrave në Njësinë Administrative

Ilir Kurti-FushëAlie

Nevojat: Afër shtëpive tona jemi 3-4 familje që nuk na hy makina në lagje. (40 m)vetëm të hapet si trase. Eshtë shumë e nevojshme.

Kryetari: Sapo të kem mundësinë do ta shof vetë si segment. Do e gjejmë një mënyrë që të marrë zgjidhje kjo gjë. Pa merak.

Dalip Alia – Fushë Alie (Lagjia ALIE)

Dalipi e nis me një falënderim për punën që është bërë gjatë 4 viteve në njësinë administrative Fushë Cidhën. Ai ngriti disa problematika për fshatin dhe lagjen e tij.

Nevojat: Fusha e Alie është e diskriminuar. Kemi dy probleme kryesore. 1 rruga dhe 2 kanali vaditës pasi ne kemi nevojë për vaditje. Duam që uji të vijë në fushë me 30 Qershor. Ka dy vite që uji na vjen në Gusht. Me thënë të drejtën jemi pak mosbesues.

Kryetari: Mbaruam Lacasin fillimisht, pastaj tjetrën dhe sigurisht që do bëhet dhe pastrimi kanaleve. Për këtë kemi dhe Agronin (drejtorin) e bujqësisë. Rruga do të bëhet lart sipas mundësisë. Unë e di shumë mirë historinë e fushë alies dhe po e shihni se po investoj në cdo njësi dhe nuk po bëj dallime. Kërkesat janë të mëdha dhe duhet të jemi bashkëpunues.

Nevojat sipas fshatrave në Njësinë Administrative

Islam Suli- Lagjia Sule

Nevojat: 4 km kanal vaditës proi kapc deri vija e dodës. Janë 3 hektar që vaditen me këtë linjë.

Agroni: Besoj do të marrë zgjidhje si gjë edhe pse cdo vit është pastruar. E din besoj.

Skënder ALIA- Fushë Alie

Falenderoj sinqerisht kryetarin e Bashkisë Dibër pasi gjithmonë ka qenë me aq mundësi sa ka pasur në ndihmën tonë. Për 35 vite sinqerisht nuk ka ardhur askush të na trokasë në derë për me na pyet si jem.

Permbledhje e kerkesave nga degjesat publike te vitit 2025																			
Nr	Njesia Administrative	Data zhvillimit te degjeses publike	Diskutanti (Emri e Mbiemer)	Fshati (qe perfshin diskutimin)	Cfare kerkohet	Asfaltim rruge	Rregullim rruge me kalidrim	Uje i Pishem	Uje vadites	Ndricim RUGOR	Sistemim i Ujrave te zeza	Pastrim Kanalesh vaditese	Sistemim mbeturinash	Problem me energjine	Shkolla, njesi shendetesore	Punetor mirembajtje	Pastrim i Uqenit	Prita per permblytjet	Pastrim Varrezash
1	Fushe Cidhe	14.11.2025	Islam Suli	Lagjia Sule			1					1							2
2	Fushe Cidhe	14.11.2025	Skender Alia	Fushe Alie			1												1
3	Fushe Cidhe	14.11.2025	Dalip Alia	Lagjia Alie			1		1			1							3
4	Fushe Cidhe	14.11.2025	Ilir Kurti	Fushe Alie			1												1
5																			0
6																			0
7																			0
8																			0
9																			0
10																			0
totali kerkesave							0	4	0	1	0	0	2	0	0		0	0	7

Dëgjesa Publike – Njësia Administrative Maqëllarë

Data: 19 Nëntor 2025


Ora: 14:00

Vendi: Lokali pranë rrugës Maqëllarë-Pecest.

Takimi në njësinë Administrative Maqëllarë u mbajt në datën 19 Nëntor 2025. Duke qenë që Maqëllara është një nga Njësitë më të mëdha në Dibër u pa e udhës që takimi të bëhej në një ambient të madh pasi numri i pjesëmarrësve ishte me të vërtetë i madh. Në këtë dëgjese publike ishte prezent kryetari i Bashkisë Dibër, z. Rahim Spahiu, Prefekti i Qarkut Dibër Nexhbedin Shehu, kryetari i këshillit bashkiak Sokol Sava, administratori i njësisë Florian Lazri. Dëgjesa Publike hap me përshëndetjen e Kryetarit të Bashkisë Dibër, **Rahim Spahiu** i cili falënderoi pjesëmarrësit dhe prezantoi një përmbledhje të investimeve të kryera gjatë vitit 2025 në Njësinë Administrative Maqëllarë. Më pas një fjalë përshëndetëse e mori dhe prefekti i qarkut duke e finalizuar kryetari i këshillit bashkiak.

Kryetari i Bashkisë Dibër Rahim Spahiu, e nisi bisedën me qytetarët me investimet që janë bërë në këtë njësi për vitin 2025 dhe më pas tregoi prioritetet e tij për vitin 2026. Disa punë që janë bërë janë rehabilitimi i lagjes Gjone, përfundimi i fazës së dytë të rrugës së Majtarës, Klobucishtit, sistemimi i trotuareve në Maqëllarë, Kopështet e Maqëllarës, Koashicës, Erebarës, dalja e rrugës së Herbelit, erebarës dhe Dovolanit, rruga e Pocesit.

Disa punë dhe proprietete që priten të bëhen këtë vit që vjen janë. Rehabilitimi i shkollës së Dovolanit (total), Asfaltimi i rrugës së Popinarës, furnizimi me ujë vadi të në Obok, riveshje asfalti në Podgorcë dhe Allajbegi, Ruga e Gradeci, Segmetni Herbel Grezhdan.



Nevojat sipas fshatrave në Njësinë Administrative Maqëllarë.

Skënder ELEZI- Gradec.

Nevojat: Sistemimi i rrugës së Gradecit. Është në gjendjen shumë të keqe.

Kryetari: E thash në fillim të bisedës që do të bëhen të gjitha rrugët. Me zhavorr do sistemohet Gradecibrenda këtyre muajve.

Petrit Beca- Burim

Nevoja: Prishja e murit të fabrika, është një burim i pastër aksidenti. Është problem i madh për ne pasi cdo ditë bëhet aksident. Është dëmtuar dhe asfalti në rrugë pasi firma për ujësjellësin ka prish dhe nuk e ka rregulluar më.

Kryetari: Do të ndjekim me përparësi të dy problematikat që the. Mëshpëjt do bëhet kjo e asfaltimit ku është dëmtuar për pak ditë por dhe për murin do të dërgojmë një grup ekspertësh.

Sami Toci-Cernenë

Nevojat: sistemi i rrugës së lagjes Farmac. Të sistemohet pasi nxënësit shkojnë me siklet në shkollë sidomos dimrit. Në Cernenë nuk është bërë asnjë investim pasi nevojat janë të mëdha zoti Kryetar.

Xheladin Kosiqi-Popinar

Nevojat: Nuk na pëlqen farë si po bëhen punimet e rrugës së Pocestit nga firma që po e bën. Uji po merret në Obok për Maqëllarën dhe duhet të kishe ardhur ta diskutonim. Nevoja për kazan mbetyrinash do ishte mirë. Kryepleqtë duhen të ndryshohen

Kryetari: Ke të drejtë për sa i përket ardhëjs time atje por ta siguroj që do vij. Edhe kazanët e mbeturinave do i sjellim. Për kryepleqtë është e shtjellshme që u takon juve. Ju i votoni.

Ramazan Koreni- Pesjakë

Nevojat: Të mbjellim akacje. Nuk kemi furnizim të mjaftueshëm me ujë, Janë bllokuar të gjitha pusetat e kanaleve të zeza kur është bërë asfaltimi i rrugës. Po dhe pusetat e ujit të bardhë.

Kryetari: Bashkia bëri asfaltimin për fshatin. Të gjitha pak nga pak do ti bëjmë pa merak.

Lutfi Gjoni- Maqëllarë

Ai e nisi bisedën më punët e mira që Bashkia Dibër ka bërë këto kohë.

Nevojat: Nevojë emergjente është zgjidhja e trafikut. Sistemimi i trotuareve sepse realisht nuk ke nga kalon. Edhe diçka e rëndësishme, të mbarohen shpejt punimet e ujësjellësit sepse po prishte asfalti dhe i riu kur të shtrohet do të priset.

Kryetari: Ke plotësisht të drejtë për sa i përket trafikut që bëhet, E kemi në mendje dhe e kemi diskutu me inxhinjerat se si ta zgjidhim. Edhe për trotualet është një projekt sic e thash në fillim.

Përmbledhje e kërkesave nga degjesat publike te vitit 2025																			
Nr	Njesia Administrative	Data zhvillimit te degjeses publike	Diskutanti (Emer e Mbiemer)	Fshati (qe perفشin diskutimin)	Cfare kerkohet	Asfaltim rruge	Regullim rruge me kalldrem	Uje i Pishem	Uje vadites	Ndricim RRUGOR	Sistemim i Ujrave te zeza	Pastrim kanalesh vaditese	Sistemim mbeturinash	Problem me energjine	Shkolla, njesi shendetesore	Punetor mirembajtje	Pastrim i Liqenit	Prita per permbytjet	Pastrim Varrezash
1	Maqellare	19.11.2025	Skender Elezi	Gradec		1	1												
2	Maqellare	19.11.2025	Petrit Beca	Burim		1													2
3	Maqellare	19.11.2025	Sami Toci	Cernene			1		1		1		1						1
4	Maqellare	19.11.2025	Xheladin Kosiqi	Popinar		1	1						1						4
5	Maqellare	19.11.2025	Ramazan Koreni	Pesjake			1						1						3
6	Maqellare	19.11.2025	Lutfi Gjoni	Maqwillare				1				1							2
7	Maqellare	19.11.2025	Bastri Gjoni	Maqwillare				1		1									2
8								1											1
9																			0
10																			0
Totali kërkesave						0	4	2	1	1	1	1	2	0		0	0		12

Dëgjesa Publike – Njësia Administrative Selishtë dhe Sllovë

Data: 21 Nëntor 2025

Ora: 14:00

Vendi: Njësia Administrative Selishtë dhe Sllovë

Takimi në njësinë Administrative Selishtë dhe Sllovë ishin takimet ëqë u organizuan të njëjtën ditë. Në takim ishin nënkryetarët Sajmir Kojnozi dhe Lorenc Cibaku.

U evidentuan problematika të ndryshme në disa fshatra, kryesisht të lidhura me gjendjen e rrugëve, furnizimin me ujë të pijshëm, kanalizimet e ujërave të zeza, mungesën e ndriçimit rrugor, si dhe nevojën për përmirësim të infrastrukturës së varrezave dhe objekteve publike. Banorët kërkuar veçanërisht përmirësimin e rrugëve, pastrimin e kanaleve vaditëse dhe sigurimin e ujit për vaditje dhe konsum.